

## Takim me shoqërinë civile

21 shtator 2022

Zonja dhe zotërinj, është kënaqësi për ne të jemi këtu dhe të flasim rreth Dhomave të Specializuara. Ndonëse kishim shpresuar të ishim të pranishëm fizikisht që të bisedonim me ju në Gjilan, vendimi u mor që aktiviteti të mbahej në internet për hir të sigurisë publike. Nuk jam këtu për të folur për politikë. Jam këtu vetëm për të dhënë informacione rreth Gjykatës.

Sa herë që flasim për DHSK-në, është e rëndësishme të kuptojmë historikun, mandatin dhe juridiksionin e saj. Për këtë arsye do të flas shkurtimisht për historikun e Gjykatës, edhe pse disa prej jush e dini tashmë, dhe më pas do të bëj një përmbledhje të ecurisë së proceseve aktuale të DHSK-së. Pas prezantimit do ju përgjigjem me kënaqësi pyetjeve që mund të kenë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës u themeluan mbi bazën e pretendimeve se disa krime të rënda, të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë (1998-2000), nuk ishin hetuar dhe kryesit e tyre nuk ishin ndjekur penalisht. Mbi të gjitha, kishte shqetësime se për trajtimin e këtyre krimeve duhej siguruar një mjedis i përshtatshëm për administrimin e duhur të drejtësisë me anë të krijimit të dhomave të veçanta e të dedikuara gjyqësore për kryerjen e këtyre proceseve penale. Për të trajtuar këto shqetësime, më 14 prill 2014, Përfaqësuesja e atëhershme e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë dhe Presidentja e atëhershme e Kosovës nënshkruan një marrëveshje ndërkombëtare me anë të Shkëmbimit të Letrave, për bartjen e kompetencave në përputhje me Kushtetutën e Kosovës për krijimin e dhomave gjyqësore të veçanta e të pavarura, që do të kishin selinë në një shtet të tretë ku do të gjykonin krimet që mund të dilnin në dritë nga hetimet e TFHS-së.

Gjithashtu, u ra dakord që këto dhoma gjyqësore të veçanta do të pasqyronin sistemin e gjykatave në Kosovë. Megjithatë, dhomat do të funksiononin sipas statutit të vet, do të miratonin rregulloren e vet të procedurës dhe provave. Në këto dhoma gjykatësit dhe personeli do të ishin vetëm ndërkombëtarë dhe çdo dënim i dhënë do të kryhej jashtë territorit të Kosovës.

Krijimi i këtyre dhomave, të veçanta dhe autonome, bazohej mbi nevojën për të garantuar që proceset të kryheshin në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, pa ndërhyrje politike dhe duke mbrojtur sigurinë, jetën dhe mirëqenien e dëshmitarëve dhe viktimave. Shkëmbimi i Letrave u ratifikua si marrëveshje ndërkombëtare nga Kuvendi i Kosovës me anë të ligjit që u miratua më 23 prill 2014.

Për të zbatuar këtë marrëveshje ndërkombëtar, në mars 2015, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës një amendament kushtetues sikurse parashikohej në Kushtetutën e Kosovës.

Në prill 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendosi se amendamenti i propozuar nuk zbehte apo cenonte të drejtat dhe liritë e garantuara nga Kushtetuta e Kosovës dhe shpalli se amendamenti ishte në përputhje me Kushtetutën dhe se ishte i domosdoshëm për Kosovën që të zbatonte detyrimet ndërkombëtare.

Amendament i propozuar hyri përfundimisht në fuqi me anë të nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës, që u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015. Neni 162 bën të qartë se “organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave [të ardhshme] të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen nga ky nen dhe nga një ligj i posaçëm”. Pikërisht, më të njëjtën ditë, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, duke themeluar kështu zyrtarisht Gjykatën.

Mandati i Gjykatës është të garantojë procese penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë, nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000, që janë kryer nga persona me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë, ose ndaj personave me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë. Gjykata trajton vetëm përgjegjësinë penale të personave dhe nuk heton apo ndjek penalisht grupe, organizata ose bashkësi etnike.

Siç e bëri të qartë Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese në Aktgjykimin e datës 26 nëntor 2020, dhe siç parashihet në Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, mandati i DHSK-së dhe ZPS-së do të vazhdojë deri kur Bashkimi Evropian të njoftojë Kosovën për përfundimin e mandatit të tyre.

DHSK-ja financohet plotësisht nga Bashkimi Evropian dhe pjesërisht nga pesë shtete kontribuuese (Shtetet e Bashkuara, Norvegjia, Zvicra, Kanadaja dhe Turqia).

Aktualisht, Dhomat e Specializuara shqyrtojnë katër çështje gjyqësore që përfshijnë tetë të akuzuar. DSHH-ja shënoi një arritje të madhe me shqiptimin e aktgjykimit të parë më 18 maj 2022, në një nga këto çështje. Dy të akuzuarit, të cilët u dënuan për shumicën e akuzave të paraqitura në Aktakuzë, kohët e fundit kanë dorëzuar njoftimin për apel kundër aktgjykimit. Është caktuar Paneli i Gjykatës së Apelit që përbëhet nga tre gjykatës për të shqyrtuar apelin kundër këtij aktgjykimi.

Javën e shkuar u mbajtën argumentet përmbyllëse në një çështje tjetër, që ka vetëm një të akuzuar. Kjo çështje shqyrtohet nga Trupi Gjykses I që përbëhet nga tre gjykatës dhe një gjykatës rezervë. Çështja e tretë gjyqësore iu transferua sot Trupit Gjykses ndërsa çështja e katërt ndodhet ende në fazën e procedurës paraprake.

Që prej shtatorit 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, dy Trupat Gjykses, panele të ndryshme të Gjykatës së Apelit, Paneli i Gjykatës Kushtetuese dhe Paneli i Gjykatës Supreme, si edhe unë si Kryetare e Gjykatës, kemi lëshuar më shumë se 1200 vendime dhe urdhra, prej të cilëve 200 ishin me gojë. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur më shumë se 150 seanca gjyqësore. Siç e tregojnë këto fakte, Dhomat e Specializuara kanë qenë tepër të ngarkuara dhe kanë punuar në mënyrë veçanërisht efikase dhe të shpejtë, falë punës së ekipit tejet të përkushtuar. Tani dëshiroj të paraqes disa hollësi lidhur me çështjet e ndryshme gjyqësore.

Do të filloj me çështjen *Prokurori i Specializuar kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj*, kundër të cilëve u ngritën akuza për dy vepra penale kundër rendit publik dhe katër vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike.

Siç u cek më lart, DHSK-ja ka shënoi një arritje të rëndësishme më 18 maj 2022, me shqiptimin e aktgjykimit të parë nga Trupi Gjykses, në DHSK. Z. Gucati dhe z. Haradinaj u shpallën fajtorë për tre nga katër akuzat e paraqitura në Aktakuzë, për pengim të personave zyrtare në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës panele dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës. Të dy të akuzuarit u dënuan me katër vjet e gjysmë, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një gjobë prej 100 eurosh secili. Z. Gucati dhe z. Haradinaj u shpallën të pafajshëm për akuzën e hakmarrjes.

Gjykimi u krye në mënyrë të shpejtë nga Trupi Gjykses. Procesi zgjati 32 ditë mes 7 tetorit 2021 dhe 3 shkurtit 2022. Gjatë kësaj kohe u thirrën gjithsej 14 dëshmitarë, u pranuan 18 deklaratat dëshmitarësh dhe u paraqitën gjithsej 237 prova materiale. Aktgjykimi u dha në mënyrë shumë efikase, vetëm brenda dy muajsh nga argumentet përmbyllëse të çështjes.

Kjo çështje ishte e ndërlikuar si nga ana e të drejtës procedurale, ashtu edhe materiale. Trupit Gjykses iu desh të zbatonte legjislacionin penal të Kosovës me shumë pak jurisprudencë orientuese ku të mbështetej. Ndonëse kjo çështje nuk kishte të bënte me krime kundër njerëzimit apo krime lufte, ajo është një çështje e rëndësishme për DHSK-në. Siç theksoi dhe Trupi Gjykses, kjo çështje ka të bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e proceseve gjyqësore si dhe sigurinë, mirëqenien dhe çlirimin nga frika të qindra personave, të cilët janë

paraqitur për të përmbushur detyrën e tyre qytetare si dëshmitarë. Mbrojtja e tyre nga frikësimi dhe dëmtimi qëndron në themelin e çdo sistemi të drejtësisë penale, qoftë ai vendor apo ndërkombëtar. Detyra e mbrojtjes ishte dhe një nga arsyet kryesore për zhvendosjen e DHSK-së dhe pikërisht kjo tregon rëndësinë e kësaj çështjeje.

Siç e përmenda, të dy të akuzuarit kanë apeluar Aktgjykimin i cili aktualisht shqyrtohet prej Panelit të Gjykatës së Apelit. Sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Procedurës dhe Provave, pritet që Aktgjykimi i Apelit, në varësi të rrethanave të çështjes, të dalë në fillim të vitit 2023.

Tani do të flas për gjykimin e z. Salih Mustafa. Z. Mustafa, i cili pretendohet se ka qenë komandant i një njësi që ka vepruar në zonën operative të Llapit, përballet me katër akuza për krime lufte.

Në këtë gjykim, që zgjati 49 ditë që prej fillimit të tij më 15 shtator 2021, u dëgjuan dëshmitë e 29 dëshmitarëve. Tetë viktimat janë pranuar si pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore dhe përfaqësohen nga i njëjti mbrojtës viktimash. Trupi Gjykes mbylli zyrtarisht fazën e paraqitjes së provave më 20 qershor dhe javën e kaluar u dëgjuan argumentet përmbyllëse.

Në përputhje me Rregulloren e Procedurës dhe Provave të DHSK-së, Trupi Gjykes duhet të shqiptojë aktgjykimin për këtë çështje brenda tre muajsh nga argumentet përmbyllëse, përveç nëse ka rrethana të jashtëzakonshme që përlligjin ndryshe. Për këtë arsye, është e mundur që aktgjykimi i dytë të shqiptohet në vitin 2022.

Çështja e tretë ka të bëjë me z. Pjetër Shala, i cili pretendohet se ka qenë anëtar i UÇK-së i vendosur në Kukës, Shqipëri. Z. Shala u arrestua në mars 2021 në Belgjikë dhe kundër tij janë ngritur katër akuza për krime lufte.

Të enjten e javës së shkuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake më njoftoi se çështja ishte gati për gjykim dhe për rrjedhojë caktova Trupin Gjykes. Deri tani, si viktimat pjesëmarrëse në këtë proces janë pranuar tetë persona.

Siç thashë më herët, kemi një çështje në fazën e procedurës paraprake, të cilën po e trajton Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Giju, nga Franca.

Çështja kundër z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi, kundër të cilëve janë ngritur katër akuza për krime lufte dhe gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit. Të akuzuarit u arrestuan në fillim të nëntorit 2020 dhe është në kryerje e sipër procedura paraprake.

Deri tani, si viktimat pjesëmarrëse në këtë proces janë pranuar gjithsej 32 persona. Shpresojmë që kjo çështje t'i transferohet një trupi gjykues deri në fund të këtij viti.

Si rezultat i veprimtarive në katër çështjet, vitin e shkuar u caktuan disa panele të Gjykatës së Apelit që të trajtonin një numër të ndryshëm aspektesh. Në panelet e caktuara, kam përdorur katër gjykatës, por me përbërje të ndryshme të paneleve, për të siguruar përputhshmëri dhe parashikueshmëri të jurisprudencës së DHSK-së. Krahas procesit të apelit në çështjen kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj, panelet e Gjykatës së Apelit kanë gjykuar aspekte lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara, paraburgimin e të akuzuarve, detyrimin për nxjerrje materiale, viktimat pjesëmarrëse si dhe kundërshtime për formën e aktakuzës.

Që prej shtatorit 2020, panelet e Gjykatës së Apelit kanë lëshuar afro 85 vendime dhe urdhra.

Më 15 gusht 2022 – ditën e parë pas pushimit veror të DHSK-së, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin ku konstatonte se z. Veseli nuk kishte arritur të demonstronte se kishte pasur shkelje thelbësore të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe në Rregulloren e Procedurës dhe Provave lidhur me vendimet e nxjerra nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Paneli i Gjykatës së Apelit me anë të së cilave urdhëronin vazhdimin e paraburgimit të tij. Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë kërkesën e z. Veseli në tërësinë e saj. Kjo është hera e parë që Paneli i Gjykatës Supreme shqyrtoi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjithashtu, këtë vit u caktua Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur në lidhje me pesë referime të paraqitura prej z. Jakup Krasniqi, z. Kadri Veseli, z. Hashim Thaçi dhe z. Pjetër Shala me anë të së cilave pretendonin se u ishin shkelur të drejtat themelore.

Dhoma e Specializuar nxori vendime të rëndësishme lidhur me këto referime më 13 qershor, 6 korrik dhe 15 gusht, me anë të së cilëve hodhi poshtë të pesë referimet si të papranueshme për shkak se aktualisht janë të parakohshme. Me fjalë të tjera, tri personat nuk mund të deklarojnë se janë viktimat e shkeljeve të pretenduara, pa përfunduar më parë gjykimi kundër tyre, pasi nuk është vendosur ende nëse janë të pafajshëm apo fajtorë për akuzat e ngritura kundër tyre.

Dëshiroj të shfrytëzoj këtë mundësi për të theksuar se për krime brenda juridiksionit të DHSK-së mund të ngrihen akuza vetëm kundër individëve, jo kundër grupeve etnike, organizatave apo subjekteve të tjera.

Vendimi se kundër kujt do të ngrihen akuza është ekskluzivisht kompetencë e Prokurorit të Specializuar, i cili vepron i pavarur dhe është forca e vetme shtytëse në këtë drejtim. Prokurori i Specializuar i merr vendimet bazuar në hetimin që kryen zyra e tij dhe në bazë të provave që ka në dispozicion. Megjithatë, na takon ne, si gjykatës të DHSK-së të garantojmë që proceset kundër personave kundër të cilëve janë ngritur akuza, të kryhen në mënyrë të drejtë dhe efikase duke respektuar të drejtat të parashikuara për ta në kornizën tonë ligjore. DHSK-ja dhe ZPS-ja janë dy institucione të ndara që janë tërësisht të pavarura nga njëra-tjetra.

Siç e shihni, Gjykata fokusohet fuqimisht në mandatin e saj. Kemi parë nga mediat se ka kritika që i drejtohen Gjykatës si dhe ka nga ata që nuk besojnë në mandatin e saj.

Si Gjykatë, nuk përfshihemi as në debate politike, as në argumente rreth punës së Gjykatës. Në fakt, DHSK-ja fokusohet që të garantojë ushtrimin e funksionit që i dha Kuvendi i Kosovës dhe sipas marrëveshjes mes Kosovës dhe BE-së me anë të Shkëmbimit të Letrave në 2014, të garantojë që proceset të kryhen në mënyrë të pavarur, të drejtë, të sigurt dhe të paanshme. Vendimet dhe aktgjykimet e DHSK-së do të demonstrojnë se DHSK-ja do ta ketë kryer mandatin e saj në mënyrë legjitime dhe të besueshme.

Në mbyllje, dëshiroj të them se jam shumë e kënaqur që pata mundësinë të flas për DHSK-në, mandatin e saj dhe çështjet aktuale dhe me kënaqësi do t'u përgjigjem pyetjeve që keni.